



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE LUSHNJE

Nr.521 Regj

Lushnje, më 14.04.2022

VENDIM – SHPALLJE

(Lidhur me ekzekutimin e “Urdhërit të Ekzekutimit” të titullit ekzekutiv të debitorit)

Në Lushnje, sot më datë 14.04.2022,

Unë Brikena Luto, me detyrë Përmbarues Gjyqësor pranë Zyrës së Përmbarimit Lushnje, pasi studiova aktet procedurale të çështjes përmbarimore nr.521, datë 04.04.2022 bazuar në urdhërin e ekzekutimit nr.84 (256) të lëshuar në datë 17.02.2022 të Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje,

K O N S T A T O V A :

Se në datë 04.04.2022 është depozituar pranë Zyrës së Përmbarimit Lushnje kërkesa e kreditorit së bashku me vendimin nr. nr.84 (256), datë 11.02.2022 të Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje me palë:

- Kreditor: Dajana Elmaz Kovaçi
- Debitor : Devis Agim Kaloti
- Me objekt: Pension ushqimor

Nga ana e Zyrës së Përmbarimit Lushnje ka filluar procedurat në bazë të nenit 515 e vijues të K.Pr. Civile si dhe ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 “ *Për Organizimin dhe Funkcionimin e Shërbimit Përmborimor Gjyqësor*”, i ndryshuar, për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv të sipërcituar.

Nga verifikimi i kryer nga ana jonë në bashkëpunim me organet kompetente rezulton se debitori Devis Agim Kaloti nuk ka marr dijeni nëpërmjet shërbimit postar, si rezultat i kësaj bazuar në nenet 133/a, 133/b dhe 144/a si dhe neni 517 të Kodit të Proçedurës Civile duhet të bëhet njoftimi me shpallje publike e debitorit lidhur me detyrimin që ka ai ndaj palës kreditore Dajana Kovaçi për në vlerën 10 000 lekë çdo muaj.

Sa më sipër në mbështetje të nenit 133/a, 133/b, dhe 144/a si dhe 517 të Kodit të Proçedurës Civile dhe ligjit nr.8730, daë 18.01.2001 “ *Për Organizimin dhe Funkcionimin e Shërbimit Përmborimor Gjyqësor*”, i ndryshuar.


V E N D O S A :

1. Të kryej njoftimin nëpërmjet shpalljes publike me afat 20 (njëzet) ditor (duke marr parasysh edhe komunimin postar), nga data 15.04.2022 – 04.05.2022 të debitorit Devis Agim Kaloti;
2. Ky vendim përpilohet në disa kopje, ku një kopje afishohet në këndin e njoftimit të Zyrës së Përmbarimit Lushnje, një kopje dërgohet për afishim pranë në këndin e publikimeve të Bashkisë Lushnje, një kopje dërgohet për afishim në ambjentet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe një kopje dërgohet për publikim në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit Tiranë.
3. Kjo shpallje publike ka vlerën e aktit të njoftimit për palën debitore Devis Agim Kaloti me banim në lagjen “ Gafurr Muço”, Lushnje
4. Pala debitore Devis Agim Kaloti me banim në lagjen “ Gafurr Muço”, Lushnje të paraqitet pranë Zyrës së Përmbarimit Lushnje në lagjen “Çlirim”, kati i parë, hyrja mbarapa në ambjentet e Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje dhe të marr kontakte me përmbaruesin gjyqësor të çështjes përmbarimore për t’iu vënë në dispozicion aktet e dosjes përmbarimore, pasi me kalimin e këtij afati do të vijohet me ekzekutim detyruar sipas nenit 519 e ne vijim të Kodit të Proçedurës Civile.

U shpall në Lushnje, sot më datë 14.04.2022

PËRMBARUESI GJYQËSOR

Brikena Luto



KRYETAR I ZYRËS

Endrin Kashari

